

VENDIM
Nr. 500, datë 10.6.2015

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 887, DATË 21.12.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË DOKUMENTIT NDRYSHUES TË MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË GREQISË, PËR PROGRAMIN DYPALËSH TË NDIHMËS SË BASHKËPUNIMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 121 e 124, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shfuqizimin e vendimit nr. 887, datë 21.12.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin, në parim, të dokumentit ndryshues të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Greqisë, për programin dypalësh të ndihmës së bashkëpunimit”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama